LIGJ
Nr. 92/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 116/2014, "PËR AKREDITIMIN E ORGANEVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 116/2014, "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 16, të nenit 3, shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:
"17. "Biobankë" është një organ që ruan mostra biologjike njerëzore dhe informacione shoqëruese të organizuara në mënyrë sistematike për qëllime kërkimore.".

Neni 2

Në pikën 1, të nenit 5, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:
a) shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:
"c) organe certifikuese të personave;";
b) pas shkronjës "e" shtohen shkronjat: "ë", "f" dhe "g" me këtë përmbajtje:
"ë) organe që kryejnë verifikimin dhe vlefshmërinë si aktivitet të vlerësimit të konformitetit;
f) biobanka;
g) organe të tjera që kryejnë veprimtari të vlerësimit të konformitetit.".

Neni 3

Pas shkronjës "g", të nenit 6, shtohet shkronja "gj" me këtë përmbajtje:
"gj) promovon rolin dhe rëndësinë e akreditimit.".

Neni 4

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
"1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit organizohet në mënyrë të pavarur nga organet e vlerësimit të konformitetit që ajo vlerëson dhe nga ndikimet tregtare të tyre, si dhe siguron mënjanimin e konfliktit të interesave.".
2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:
"7. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon procedurat e nevojshme për të siguruar menaxhimin efikas dhe kontrollet e duhura të brendshme. Kontrollet e brendshme kryhen nga audituesvendas ose të huaj, me kompetencë në fushën e akreditimit.".

---

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me rregulloren (KE) nr. 765/2008, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, "Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e rregullores (KEE) nr. 339/93", e ndryshuar.
Numri CELEX: 32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 218, datë 13.8.2008, faqe 30–47.

Neni 5

Pika 2 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

"2. Të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, sipas pikës 2, të nenit 5 të ligjit, përdoren në masën 90 për qind nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për:

a) pagesën e vlerësuesve teknikë vendas, që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të vlerësuesve teknikë të huaj dhe të audituesve vendas ose të huaj;

b) shpenzimet e akomodimit e të transportit të vlerësuesve teknikë dhe audituesve vendas ose të huaj;

c) shpenzimet e trajnimeve dhe zhvillimin e vlerësuesve teknikë e të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;

ç) promovimin e akreditimit;

d) përmirësimin e infrastrukturës së akreditimit.".

Neni 6

Pika 1 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

"1. Ankimi kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet brenda 30 ditëve nga data kur ankimuesi ka marrë njoftim te drejtori i Përgjithshëm i Akreditimit, i cili përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ankimit.".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 337, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.